

SHOQËRIA BIG ROSKOVECI SHPK
NIPT L93501401J

Adresa: Rruga Dervish Hekalli, Lagaj 29 Nentori, Pranë shkollës së Muzikës.

VENDIM

NR. 02, DATË 19. 04. 2021

I

ASAMBLESE SË ZAKONSHME TË SHOQËRISË "BIG ROSKOVECI" SHPK

Asambleja e zakonshme e Shoqërisë "Big Roskoveci" sh.p.k, e mbledhur sot, më datë 19. 04. 2021, në selinë e ortakut Bigalb Group ne Vaqarr, Gropaj, Tiranë me pjesëmarrjen e ortakut Shoqëria "BIGALB GROUP" sh.p.k., përfaqësuar nga Znj. Elona Koshi, me cilesinë e "Personit të Besuar" Z. Vullnet Sinaj, ortak i vetëm i shoqërisë "BIGALB GROUP" sh.p.k. dhe ortakes Znj. Mirela Sulaj me qëllim përmirësimin e administrimit të shoqërisë, bazuar në ligjin Nr. 9901, date 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe shoqëritë Tregtare", i ndryshuar dhe të ligjit Nr.9723 date 03.05.2007 "Për regjistrimin e biznesit" i ndryshuar,

VENDOSI

1. Pas nenit 9 të Statutit të shoqërisë të shtohet Neni 9/1 me këtë përmbajtje:


Neni 9/1


- 9.1.1** Ortaku "BIGALB GROUP" sh.p.k ka të drejtë vote të barabartë me një kuotë prej 51% të Kapitalit të regjistruar të shoqërisë dhe ka të drejtë të plotë vendimarrje sipas kuotës së përcaktuar 51%, por në këtë mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë është vendosur që: **Ortaku "BIGALB GROUP" sh.p.k, vetëm për sa i përket fitimit, do të përfitojë 50% të fitimit të deklaruar nga shoqëria në pasqyrat financiare.**
- 9.1.2** Ortaku Mirela Sulaj ka të drejtë vote të barabartë me një kuotë prej 49% të Kapitalit të regjistruar të shoqërisë dhe ka të drejtë të plotë vendimarrje sipas kuotës së përcaktuar 49%, por në këtë mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë është vendosur që: **Ortaku Mirela Sulaj, vetëm për sa i përket fitimit, do të përfitojë 50% të fitimit të deklaruar nga shoqëria në pasqyrat financiare.**
- 9.1.3** Të drejtat e përfitimit të dividendit, sa më sipër, nuk janë të transferueshme tek të tretët pa pëlqimin e të gjithë ortakëve të shoqërisë.

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME ORTAKËT


BIGALB GROUP sh.p.k.

Elona KOSHI





Mirela Sulaj



SHOQËRIA BIG ROSKOVECI SHPK
NIPT L93501401J

Adresa: Rruga Dervish Hekalli, Lagaj 29 Nentori, Pranë shkollës së Muzikës.

VENDIM

NR. 03, DATË 19. 04. 2021

I

ASAMBLESE SË ZAKONSHME TË SHOQËRISË “BIG ROSKOVECI” SHPK

Asambleja e zakonshme e Shoqërisë “Big Roskoveci” sh.p.k, e mbledhur sot, më datë 19. 04. 2021, në selinë e ortakut Bigalb Group ne Vaqarr, Gropaj, Tiranë me pjesëmarrjen e ortakut Shoqëria “BIGALB GROUP” sh.p.k., përfaqësuar nga Znj. Elona Koshi, me cilesinë e “Personit të Besuar” Z. Vullnet Sinaj, ortak i vetëm i shoqërisë “BIGALB GROUP” sh.p.k. dhe ortakut Znj. Mirela Sulaj në lidhje me zbatimin e nenit 70 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, nenit 28 të ligjit nr.9367/2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar dhe të ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;

VENDOSI


1. Shoqëria nuk do të kryejë asnjë veprimtari fitipurëse që buron nga pasuria e shtetit ose pushtetit vendor dhe as të fitojnë pasuri të ketyre, me qëllim zbatimin me korektesi të pikës 3 të nenit 70 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.
2. Administratori i shoqërisë nuk ka të drejtë dhe kompetencë për të nënshkruar kontrata apo çdo lloji marëveshje që, në një mënyrë apo tjetër, ka lidhje me veprimtari fitipurëse që buron nga pasuria e shtetit ose pushtetit vendor dhe as të fitojnë pasuri të ketyre.
3. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohet administratori i shoqërisë
4. Te depozitohet ky vendim pranë Qendres Kombetare te Regjistrimit (QKR)

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E SHOQËRISË BIG ROSKOVECI ORTAKËT

BIGALB GROUP sh.p.k.

Elona KOSHI



Mirela Sulaj

